



## STATUTI I SINDIKATËS SË BASHKUAR TË ARSIMIT, SHKENCËS DHE KULTURËS SË KOSOVËS

### DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

- Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Republikës së Kosovës ( në tekstin e mëtejshëm SBASHK ), është Federatë Sindikale e regjistruar në ministrinë përkatëse në përputhje me Ligjin nr. 04/L-011 për organizimin sindikal në Kosovë, e cila vepron si organizatë e pavarur nga shteti dhe partitë politike, demokratike, jofitimprurëse, që përfaqëson interesat e të punësuarve në institucionet publike dhe private të arsimit, shkencës dhe kulturës me anëtarësim vullnetar. Përkrahë dhe mbrojnë interesat e tyre ekonomike dhe statusin social, të drejtat e punëtorëve anëtarëve të SBASHK-ut, shpreh qëndrime veta lidhur me ngjarjet karakteristike sociale në vendin tonë dhe në botë.

Shoqatat e të papunëve, pensionistët, invalidët dhe grupe të ngjashme në arsim dhe institucionet e tjera të arsimit, mund të bashkohen me anëtarësimin e SBASHK-ut.

SBASHK-u vepron brenda sistemit të Republikës së Kosovës, në frymën e Kushtetutës, Konventave ndërkombëtare, ligjeve, kontratave kolektive, rregulloreve e akteve tjera normative të njohura dhe Programit të Statutit të SBASHK-ut.

-SBASHK-u përfaqëson interesat e anëtarëve të saj në fushat sociale, ekonomike, shoqërore, shkencore, kulturore dhe të tjera.

-Bashkëpunon në parimet e barazisë, reciprocitetit dhe solidaritetit të punës me sindikatat e tjera në vend dhe jashtë vendit si dhe me Organizatat ndërkombëtare të sindikatave simotra në përputhje me angazhimet e tyre programore.

-SBASHK-u përbëhet nga anëtarësia e të punësuarve në lëmin e arsimit, shkencës e kulturës në Republikën e Kosovës të regjistruar vullnetarisht; si në institucionet publike, private dhe të tjera, parashkollor, fillor, të mesëm të ultë, të mesëm të lartë, arsimit special, universitar, dhe shtëpitë e studentëve, si dhe subjekteve të tjera që lidhen me arsimin, shkencën e kulturën.

-SBASHK-u në përputhje me interesat e anëtarësisë, vullnetarisht bashkohet dhe përkrahë aktivitete të tjera sindikale që organizohen nga Federatat dhe Konfederatat Sindikale të Republikës së Kosovës për kryerjen më efikase, përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të përbashkëta dhe të përgjithshme të të gjithë të punësuarve.

-SBASHK-u bashkëpunon direkt me sindikatat në aktivitete sindikale në Republikën e Kosovës në mënyrë që me sukses t'i adresojë çështjet me interes të përbashkët.

-SBASHK-u me sindikatat e tjera mund të hyjë në aleanca, të llojë bashkëpunon me sindikatat përkatëse dhe sindikatat ndërkombëtare në mënyrë që të kontribuon në zhvillimin dhe përmirësimin e bashkëpunimit ndërkombëtar.

-Bashkëpunon me Sindikatat Ndërkombëtare të Arsimit dhe sindikatat tjera në mënyrë të drejtpërdrejtë ose përmes Internacionales së Arsimit (EI), anëtare e së cilës është si dhe Statuti i SBASHK harmonizohet me statutin EI.

Neni 1.

Emërtimi i Sindikatës është: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Republikës së Kosovës, në tekstin e mëtejshëm SBASHK.

Neni 2.

Selia e SBASHK-ut është në Prishtinë, Rruga "Agim Ramadani" p.n. Qendra e Studentëve –Drejtoria

### VULA E RRUMBULLAKËT, VULA KATRORE DHE EMBLEMA

Neni 3.

1. SBASHK-u ka vulën e rrumbullakët dhe emblemën.

1.1. Vula ka formën e rrumbullakët me emërtimin dhe selinë e SBASHK-ut dhe në mes emblemën.

1.2. Teksti i vulës është i shkruar në gjuhën shqipe dhe angleze: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës e Kulturës e Republikës së Kosovës - SBASHK dhe The Union of Education, Science and Culture of Republic of Kosova.

1.3. Vula katrore ka formën e katërkëndëshit kënddrejtë dhe përmban shënimet nga paragrafi i mëparshëm, me hapësirë të zbraza për numrin dhe datën.

2. Emblema e SBASHK-ut ka tri libra të hapur me mbishkrimin SBASHK.

Neni 4

Sindikata ka llogaritë e veta në Bankat e licencuara të Republikës së Kosovës.

## Neni 5.

SBASHK-u është e organizuar në: shoqata sindikale, nivele komunale, dhe nivel qendror.

1. Anëtarësia e SBASHK-ut përbëhet nga të punësuarit në fushat e mëposhtme:

- 1.1- Arsimi Parauniversitar;
- 1.2- Arsimi Universitar,
- 1.3- Shkencë;
- 1.4- Kulturë;
- 1.5- Shtëpitë e Studentëve;
- 1.6- Arsimit dhe aftësimit profesional dhe arsimit për të rritur.

2. E drejta e anëtarësimit në SBASHK nuk varet nga: gjinia, raca, origjina kombëtare ose etnike, ngjyra, moshë, shëndeti, paaftësia, feja, mendimi politik ose tjetër, origjina kombëtare ose sociale, statusi familjar, statusi ekonomik, orientimi seksual ose rrethanave të tjera personale.

## Neni 6

## STATUTI

1. Statuti është normativ i brendshëm ligjor më i lartë i SBASHK-ut.
2. Statuti i SBASHK-ut miratohet, ndryshohet dhe plotësohet nga Kongresi me shumicë votash të të gjithë delegatëve (50%+1) pjesëmarrës.
3. Iniciativën për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit mund të jap çdo anëtar i SBASHK-ut përmes shoqatës sindikale. Nxitësit e ndryshimeve dhe plotësimeve të statutit mund të jenë shoqatat sindikale, nivelet komunale, nivelet arsimore, Kryesia e SBASHK-ut, Këshilli Drejtues, Komisioni Statutor ose të paktën një e treta e delegatëve të Kongresit.
4. Këshilli Drejtues cakton një afat kohor për propozimet, për ndryshime në nenet e statutit.
5. Pavarësisht nga paragrafi i dytë i këtij neni, ndryshimet në statut, që nuk prekin organizimin e brendshëm të SBASHK-ut dhe kur gjykohet e nevojshme për funksionimin më të mirë të SBASHK-ut, mund t'i bëjë Këshilli Drejtues me një shumicë prej dy të tretave të të gjithë anëtarëve të Këshillit Drejtues dhe me pëlqimin e Komisionit Statutor, ndërsa lëshimet teknike dhe ligjore në statut i korrigjon Komisioni Statutor pas aprovimit nga Kryesia.

## Neni 7

## ANËTARËSIMI NË SBASHK

1. Anëtar i SBASHK-ut mund të jetë: çdo i/e punësuar në fushat e cekura në nenin 5, që sipas ligjit në fuqi ka plotësuar moshën e punësimit, përveç punëdhënësit.
2. Anëtarësimi në SBASHK bëhet në baza vullnetare, përmes deklaratimit me shkrim për pranimin e programit dhe statutit.
3. Gjatë aplikimit për anëtarësim, duhet të jepet deklarata me shkrim si dhe të plotësohet formulari, i cili duhet të ketë emrin dhe mbiemrin, gjininë, datëlindjen, vendbanimin, adresën, profesionin, vendin e punës dhe nënshkrimin e anëtarit.
4. Anëtarit të SBASHK-ut i jepet kartela e anëtarësisë si dëshmi për anëtarësim.
5. Anëtari i SBASHK-ut është i obliguar të paguaj rregullisht anëtarësinë mujore sindikale në shumën të cilën e cakton organi kompetent i SBASHK-ut.
6. Anëtari i një sindikate nuk mund të jetë njëkohësisht edhe anëtar i sindikate tjetër.
7. Me nënshkrimin personal të deklaratës për anëtarësim nga të punësuarit krijohen raporte të të drejtave dhe detyrimeve për anëtarin e SBASHK-ut sipas Statutit.

## Neni 8

## ZGJEDHJET NË SINDIKATË

1. Të gjithë anëtarët e sindikatës kanë të drejtë të zgjedhin dhe të jenë të zgjedhur, në kuvendet në të cilat janë të deleguar,
2. Të drejtën për t'u zgjedhur nuk do ta gëzojnë anëtarët të cilët:
  - 2.1. kanë pozitën e punëdhënësit,
  - 2.2. janë të zgjedhur dhe të emëruar në organet udhëheqëse të pushtetit lokal e qendror,
  - 2.3. janë të zgjedhur në strukturat udhëheqëse të partive politike në nivel lokal e qendror,
  - 2.4. janë të përjashtuar nga SBASHK-u apo të larguar me vullnet në kohëzgjatje prej 4 viteve
3. Anëtarët e zgjedhur mund të japin dorëheqje apo të shkarkohen nga detyra nga organi i cili i ka zgjedhur, apo nga



- Kryetari i SBASHK-ut, në pajtim me dispozitat ligjore dhe statutore .
4. Zgjedhjet ne SBASHK ne te gjitha nivelet qe nga Shoqata sidikale, Niveli komunal. Nivelet arsimore dhe Kongresi mbahen të paktën 3 muaj para skadimit të mandateve, të zgjedhurit ne secilin pozicion mandatin e marrin pasi të skadon mandati i pararendësve te tyre.

Neni 9

NDËRPRERJA E ANËTARËSIMIT NË SBASHK

1. Anëtarit të SBASHK-ut do t'i pushojë anëtarësia sipas Ligjit dhe Statutit në këto raste:
  - 1.1. Kur anëtari largohet nga SBASHK-u me vullnet të shprehur përmes deklaratës me shkrim, përmes fletë ç'anëtarësimit dhe dorëzimit të kartelës sindikale;
  - 1.2. Kur anëtari vepron në kundërshtim me Ligjin, Statutin, vendimet dhe aktet e tjera të SBASHK-ut;
  - 1.3. Kur anëtari nuk e paguan anëtarësinë tre (3) muaj me radhë, përveç kur është në pushim të lehonisë;
  - 1.4. Ndryshon statusin e punës ose kalon në ndonjë punë tjetër, ndryshe nga neni 5;
  - 1.5. Nëse merr pjesë në një aktivitet për shpërbërje të SBASHK-ut, ose mbështet aktivitetet e tilla;
  - 1.6. Nëse bëhet anëtar i sindikatës tjetër apo ndonjë këshilli iniciues për formimin e ndonjë organizate sindikale;
  - 1.7. Nëse ka keqpërdor pozitën brenda organizatës ku punon apo funksionit në SBASHK;
  - 1.8. Në rastin e pensionimit të të punësuarit;
  - 1.9. Kur anëtari vdes.
2. Shoqata sindikale e cila nuk i kryen detyrimet e kuotizimit apo detyrimet e tjera ligjore dhe statutore brenda periudhës tre (3) mujore, përjashtohet nga SBASHK-u;
3. Të dhënat nga paragrafi 2. të këtij neni, do t'i konstatojë shërbimi kompetent financiar i SBASHK-ut.
4. Vendimin për largim nga anëtarësia e SBASHK-ut e ndonjë anëtar, që nuk sillet në pajtueshmëri me statutin dhe rregulloret e SBASHK-ut, e merr Kryetari i SBASHK-ut apo Këshilli Drejtues i SBASHK-ut.

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ANËTARIT

Neni 10

Të drejtat e anëtarit të SBASHK-ut

1. Anëtari i SBASHK-ut, ka këto të drejta:
  - 1.1 Ka ndikim të drejtpërdrejtë në forcimin, qëndrimet dhe kërkesat e shoqatës sindikale ku vepron;
  - 1.2 Ka të drejtën e mbështetjes financiare dhe solidaritetit, në rast të një keqësimi të gjendjes shëndetësore apo sociale, në pajtim me Rregulloren e Fondit të Solidaritetit nëse ekziston;
  - 1.3 Ka të drejtë për ndihmë juridike falas dhe përfaqësim ligjor falas nga SBASHK-u lidhur me të drejtën e punës;
  - 1.4 Trajnimit dhe aftësimin për punët sindikale;
  - 1.5 Të zgjedh dhe të jetë i zgjedhur në organet sindikale ( nga shoqata deri në SBASHK )
  - 1.6 Të shfrytëzojë vetë të drejtat që dalin nga Kontrata Kolektive dhe mbrojtjes ligjore në rast të moszbatimit të saj;
  - 1.7 Merr pjesë në përpilimin dhe zbatimin e politikave sindikale në nivele përkatëse;
  - 1.8 Edukohet dhe aftësohet për të gjitha veprimet sindikale, që përfshijnë format e veprimit sindikal të SBASHK-ut.
  - 1.9 Të informohen menjëherë e saktë për të gjitha çështjet, që kanë të bëjnë me pozitën materiale dhe sociale përmes kryetarit të shoqatës sindikale ku vepron;
  - 1.10 Merr iniciativë përmes shoqatës sindikave për të kërkuar përgjegjësi dhe sanksione për anëtarët e organeve të niveleve përkatëse dhe të SBASHK-ut, nëse ata nuk zbatojnë politikën, qëndrimet dhe vendimet e aprovuara të SBASHK-ut;
2. Gëzon të drejta dhe privilegje të tjera që ofron SBASHK-u.

Neni 11

Anëtari i SBASHK-ut i realizon të drejtat e tij sindikale kryesisht në shoqatat sindikale. Në rast se shoqata sindikale e tij nuk mund të sigurojë mbrojtjen e kësaj të drejte atëherë anëtari iu drejtohet nivelit komunal apo universitar e pastaj edhe autoriteteve të larta të SBASHK-ut .

Neni 12

Detyrimet e anëtarëve të SBASHK-ut:

Anëtarët e SBASHK-ut obligohen që:

1. Të veprojnë në përputhje me Statutin, rregulloret, vendimet dhe aktet tjera normative të SBASHK-ut,
2. Të marrin pjesë aktivisht në veprimet sindikale;
3. Të paguajnë rregullisht kuotën sindikale në përputhje me Statutin dhe të kujdesen në nivelet përkatëse për qëllimin dhe përdorimin e saj.

1. Anëtari i cili e ka humbur të drejtën që të jetë anëtar i SBASHK-ut sipas nenit 9, ka të drejtë të ankohet në Komisionin Statutor të SBASHK-ut brenda 15 ditëve. Me humbjen e të drejtës që të jetë anëtar përfundojnë të drejtat dhe detyrimet ndaj SBASHK-ut, si dhe e SBASHK-ut ndaj anëtarit.
2. Anëtari i SBASHK-ut, i cili ishte fshirë nga regjistri ose është dëbuar nga anëtarësimi mund të kthehet me kërkesën e tij ose me iniciativën e shoqatës sindikale përsëri në SBASHK pa të drejtë zgjedhje në organet udhëheqëse për 4 vite.
3. Vendimin për këtë e merr, Kryetari i SBASHK-ut me propozim të shoqatës sindikale në konsultim me organet tjera të SBASHK-ut

#### DETYRAT E SBASHK-ut

Qëllimet, objektivat, format dhe metodat e veprimtarive sindikale

#### Neni 14

Detyrat e SBASHK-ut janë:

1. Mbrojtja e garantuar ligjore e të drejtës për punë dhe të drejtave nga marrëdhënia e punës;
2. Mbrojtja e interesave materiale të anëtarëve;
3. Përparimi i kushteve të punës dhe të jetës;
4. Kontribuon për të adresuar çështjet e strehimit;
5. Informimi objektiv dhe me kohë;
6. Angazhohet për bashkëpunim me ndërmarrje dhe persona të tjerë juridik në funksion të interesave të anëtarëve;
7. Zhvillimi dhe përmirësimi i funksionimit të Kontratës Kolektive;
8. Pjesëmarrja në autoritetet përkatëse shtetërore dhe lokale në fushën e arsimit, shkencës e kulturës
9. Pjesëmarrje në komisione për hartimin e akteve ligjore që kanë të bëjnë me interesin e anëtarësisë si dhe tryeza
10. Forcimi i dialogut social dhe partneritetit me punëdhënësin;
11. Të kontribuoj në edukimin dhe zhvillimin profesional të anëtarëve;
12. Studion dukuritë e mbetjes pa punë të anëtarëve, që shkaktohen nga ndërrimet në organizimin e tërësishëm të procesit edukativo- arsimor e kulturor dhe merr masa për mënjanimin e atyre dukurive.
13. Angazhohet në ngritjen e pozitës materiale, sociale e kulturore të anëtarësisë.

#### 1.1.1 LIDHJA E KONTRATAVE KOLEKTIVE

#### Neni 15

Me qëllim të kryerjes së funksionit të vetë, SBASHK-u ka të drejtë ekskluzive që të nënshkruaj Kontrata Kolektive me Ministrinë përkatëse ( MASHTI, MKRS ) dhe asociacione të ndryshme ekonomiko-shoqërore, ku do të precizohen të drejtat dhe obligimet e ndërsjella.

#### Neni 16

#### BURIMET FINANCIARE TË SBASHK-ut

1. Mjetet financiare për fushëveprimin sindikal sigurohen nga:
  - 1.1. kuota e anëtarësisë,
  - 1.2. donacionet e ndryshme,
  - 1.3. ndihmat solidare,
  - 1.4. të hyrat nga prona e SBASHK-ut dhe
  - 1.5. burimet e tjera që nuk janë në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe statutore.
2. Punëdhënësi siguron mbledhjen e kuotës së anëtarësisë në mënyrë institucionale. Mjetet nga kuota e anëtarësisë do të derdhen në xhirollogarinë e SBASHK-ut.
3. SBASHK-u në fund të çdo viti fiskal, sipas dispozitave ligjore në fuqi, bënë një auditim të jashtëm të mjeteve të shpenzuara ( pasqyrave financiare ).
4. Mjetet financiare të anëtarësisë sindikale barten dhe shpenzohen në formën institucionale në pajtim me vendimin e organit kompetent të Shoqatës Sindikale ( për shoqatat sindikale ), nivelit komunal apo universitar ( për NSKAP apo NSUSH ose NSU ),përkatësisht SBASHK-ut, sipas planifikimit buxhetor paraprak nga secili nivel i organizimit.



1. Lartësia e kuotës së anëtarësisë është 0.5 % e të ardhurave personale neto, ku 0.5% ndahët në:
  - 1.1. 40% shoqatës sindikale;
  - 1.2. 10% sindikatës së nivelit komunal apo universitar;
  - 1.3. 12% për anëtarësinë në konfederatë dhe për pagesën e pushimit dhe rekreacionit të anëtarësisë;
  - 1.4. 8% anëtarësia në EI/ETUCE dhe pagesa për trajnime të anëtarëve.
  - 1.5. 30% SBASHK-ut, kurse:
2. Menaxhimi dhe përdorimi i mjeteve rregullohet me rregullore që nxjerr Kryetari i SBASHK-ut, Kryesia apo Këshilli Drejtues i SBASHK-ut dhe bazuar në paragrafin 1 dhe nënparagrafët e këtij paragrafi, secili përfitues jep llogari për pjesën e vet sipas këtyre rregulloreve.

#### MJETET E VEPRIMIT

##### Neni 18

Me rastin e cënimit të së drejtës së punëtorit, të Kontratave Kolektive ose të mosrespektimit të Ligjit apo akteve tjera normative nga ana e punëdhënësit, SBASHK-u i përdorë këto mjete presioni:

1. Tërheq vërejtjen dhe zhvillon bisedime lidhur me to;
2. Bën kërkesë me shkrim për respektimin e Kontratës Kolektive dhe të normave ligjore;
3. Ushtron padi në organet përkatëse;
4. Angazhohet që konflikti të zgjidhet përmes institucioneve kompetente;
5. Tërheq vërejtjen e fundit për ndërprerjen e punës dhe merr vendim për hedhje në grevë në bazë të ligjeve në fuqi.

#### GREVA

##### Neni 19

1. Greva është mjeti legjitim më i fuqishëm i presionit sindikal për realizimin e të drejtave dhe interesave të anëtarëve.
2. Greva organizohet vetëm atëherë kur dështon çdo përpjekje për t'u arritur marrëveshja ose kur institucioni nuk dëshiron bisedime.
3. Greva mund të organizohet në nivele: shoqatë sindikale, komunale, nivele arsimore dhe në nivel qendror.
4. Në të gjitha rastet duhet të jepet pëlqimi nga organi përkatës dhe të njoftohet Kryesia e SBASHK-ut gjegjësisht KD i SBASHK-ut, përveç në rast të një greve në shoqatë sindikale të cilat kërkojnë pëlqimin e Kryesisë së SBASHK-ut.

##### Neni 20

Iniciativën për hedhje në grevë, varësisht prej kushteve dhe rrethanave, mund ta marrë:

1. Shoqata Sindikale;
2. Niveli Komunal;
3. Nivelet Qendrore të SBASHK-ut.

##### Neni 21

1. Vendimi për hedhje në grevë në nivel shoqate merret me pëlqimin e  $\frac{1}{2}$  të anëtarëve të shoqatës sindikale.
2. Vendimi për hedhje në grevë në nivel komunal merret me shumicë votash, nëse për këtë paraprakisht kanë dhënë pëlqimin  $\frac{1}{2}$  e anëtarësisë në nivelin komunal.
3. Vendimin për hedhje në grevë në nivel vendi e merr *Këshilli Drejtues* me shumicë votash, ose Kryetari i SBASHK-ut nëse për këtë paraprakisht kanë dhënë pëlqimin  $\frac{1}{2}$  e anëtarësisë në nivel vendi.
4. Të gjitha nivelet që marrin vendim për grevë, duhet ta njoftojnë me shkrim nivelin më të lartë se ai nivel.

##### Neni 22

1. Për çdo grevë formohet Këshilli Grevist, i cili udhëheq dhe mbikëqyrë grevën.
2. Greva ndërpritet pasi që të përmbushen kërkesat e grevistëve, përkatësisht kur arrihet marrëveshja rreth kërkesave ose kur vlerësohet nga organi, i cili ka marrë vendim për hedhje në grevë, se vazhdimi i mëtejme i grevës nuk ka efekt.

##### Neni 23

Para se të merret vendimi për fillimin e grevës, me qëllim që t'i tërhiqet vërejtja punëdhënësit mund të ndërpritet puna, por jo më shumë se një ditë pandërpre.

Neni 24

1. Sindikata siguron kushte për mbarvajtjen e grevës, ndërkaq anëtarët gjatë kësaj kohe duhet të marrin pagën e plotë, pasi këtë ia garanton ligji mbi grevën.
2. Për nevojat e përkrahjes materiale të grevistëve mund të formohet fondi i grevës.
3. Mënyra e formimit dhe e përdorimit të mjeteve nga ky fond rregullohet me vendim të veçantë.

ORGANIZIMI

Neni 25

1. Fedarata sindikale SBASHK organizohet në këtë formë :
  - 1.1 Shoqata sindikale SHS
  - 1.2 Federata sindikale SBASHK
2. Dhe ka një organizim të brendshëm në këtë mënyrë:
  - 2.1 Nivelet komunale dhe të universiteteve.
  - 2.2 Nivelet arsimore
    - 2.2.1 Niveli parafillor, fillor dhe i mesëm i ulët
    - 2.2.2 Niveli i arsimit të mesëm të lartë
    - 2.2.3 Niveli i arsimit të lartë.
  - 2.3 Niveli i kulturës.

SHOQATA SINDIKALE (SHS)

Neni 26

Shoqata Sindikale është njësia themelore e SBASHK-ut

1. Shoqata Sindikale formohet mbi parimin e një institucioni-një shoqatë sindikale, e cila duhet të ketë se paku 10 anëtarë.
2. Punonjësit nga dy ose më shumë institucione më të vogla, në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni, mund të formojnë një shoqatë sindikale.
3. Punonjësi i një institucioni, që nuk ka shoqatë sindikale, mund t'i bashkëngjitet një shoqate tjetër sindikale apo të formojë shoqatë sindikale në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni me punonjës të tjerë që nuk kanë shoqata sindikale.

Neni 27

Organizimi i brendshëm dhe funksionimi i shoqatës sindikale janë të rregulluara me rregullat e shoqatave sindikale të institucioneve përkatëse .

1. Shoqata Sindikale është një entitet juridik.
2. Shoqata Sindikale ka llogarinë e saj bankare në kuadër të SBASHK-ut.

Neni 28

Shoqata Sindikale

1. Bënë shqyrtimin e legjislacionit të propozuar që do të ndërmerret në nivel të institucionit përkatës lidhur me pozitën ekonomike dhe sociale të punonjësve dhe jep një mendim;
2. Mbron të drejtat për punë dhe të drejtat sociale të anëtarëve të shoqatave sindikale;
3. Vendos për greva dhe forma të tjera të veprimeve sindikale në nivel të shoqatës;
4. Shqyrton dhe vendos për propozimet dhe iniciativat e anëtarëve të saj dhe organeve të SBASHK-ut;
5. Monitoron dhe mbikëqyr zbatimin e ligjeve dhe kontratën kolektive në nivel shoqate;
6. Ballafaqohet me ankesat në lidhje me realizimin e të drejtave të punës së anëtarëve;
7. Miraton raportin e përfaqësuesve të shoqatës sindikale dhe ofron udhëzime për punën e tyre;
8. Propozon kandidatët për përfaqësuesit e punonjësve;
9. Propozon masa për të punuar në një mjedis të sigurt të punës;
10. Bënë organizime kulturore, sportive dhe aktivitete të tjera me interes për anëtarësinë;
11. Pagan kuotën sindikale në përputhje me Statutin dhe vendimet e përcaktuara nga SBASHK-u;



12. Zbaton vendimet e organeve të SBASHK-ut;

13. Zgjidh kërkesat e anëtarëve të saj etj.

## ORGANET E SHOQATËS SINDIKALE

Neni 29

Organet e Shoqatës Sindikale janë:

1. Kuvendi i Shoqatës Sindikale
2. Kryesia e Shoqatës Sindikale
3. Komisioni Mbikëqyrës i Shoqatës Sindikale

## KUVENDI I SHOQATËS SINDIKALE

Neni 30

1. Kuvendi është organi më i lartë i Shoqatës Sindikale.
2. Kuvendi përbëhet nga të gjithë anëtarët e Shoqatës Sindikale. Kuvendi duhet të mbledhet së paku katër herë në vit. Nëse është e nevojshme mund të thirret më parë me kërkesën e një të tretës së anëtarësisë apo të Kryesisë së Shoqatës Sindikale.
3. Kuvendi shqyrton rezultatet e Shoqatës Sindikale, miraton raportin e punës dhe atë financiar të kryesisë, përcakton prioritetet e organizimit të aktiviteteve sindikale.
4. Miraton rregullat për punën e Shoqatës Sindikale, zgjedh kryetarin, nënkryetarin dhe anëtarët e Kryesisë së Shoqatës Sindikale dhe Komisionin Mbikëqyrës.
5. Kuvendi i Shoqatës Sindikale zgjedh dhe shkarkon Kryetarin, Nënkryetarin, anëtarët e Kryesisë, delegatët për Kuvendin e NSKAP apo Sindikatës Universitare, Komisionin Mbikëqyrës dhe komisione të përfaqësues tjerë duke u bazuar në nevojën reale për funksionimin e shoqatës sindikale.

## KRYESIA E SHOQATËS SINDIKALE

Neni 31

1. Kryesia e Shoqatës Sindikale përbëhet nga kryetari, nënkryetari dhe anëtarët e zgjedhur në Kuvendin e SHS nga anëtarët e Shoqatës Sindikale.
2. Kryetari, Nënkryetari, Anëtarët e Kryesisë dhe anëtarët e Komisionit Mbikëqyrës të SHS zgjedhen nga Kuvendi SHS, nga radhët e anëtarëve të SHS me votim të fshehtë ndërmjet dy ose më shumë kandidatëve.
3. Kryetari dhe Nënkryetari i SHS së paku njëri nga ta, të jetë i gjinisë femërore.
4. Kryesia e Shoqatës Sindikale, në emër të anëtarëve të vet, kryen këto punë:
  - 1.1. Monitoron zbatimin e kontratës kolektive në nivel të institucionit, inicion ndryshimet e saj etj.
  - 1.2. Siguron kushtet për informim të rregullt, të plotë dhe të vërtetë të punonjësve anëtarë të SBASHK-ut, për çështjet që ndikojnë në punën socio-ekonomike e në bazë të ligjeve në fuqi;
  - 1.3. Përgatit programin e punës, raportin vjetor dhe pasqyrat financiare për anëtarësinë;
  - 1.4. Siguron kushte, që anëtarët e Shoqatës të paguajnë detyrimet rregullisht;
  - 1.5. Fondet e Shoqatës Sindikale të përdorën ekskluzivisht për veprimtari sindikale në përpuethshmëri me rregullat e SBASHK-ut dhe rregullat financiare të Republikës së Kosovës;
  - 1.6. Ballafaqimi me çështje të tjera me interes për anëtarësinë;
5. Kryesia e shoqatës sindikale përbëhet nga 3 deri në 5 anëtarë.

## KOMISIONI MBIKËQYRËS I SHOQATËS SINDIKALE

Neni 32

1. Komisioni Mbikëqyrës i Shoqatës Sindikale mbikëqyrë përdorimin e fondeve financiare dhe të tjera dhe e informon shoqatën sindikale.
2. Komisioni Mbikëqyrës, përbëhet nga anëtarët e zgjedhur nga kuvendi i shoqatës sindikale.
3. Anëtarë të Komisionit Mbikëqyrës, nuk mund të jenë njëkohësisht anëtarët e Kryesisë së Shoqatës Sindikale dhe anasjelltas.
4. Kuvendi dhe Kryesia e Shoqatës Sindikale do të marrë në konsideratë raportet dhe konkluzionet e Komisionit Mbikëqyrës.
5. Komisioni Mbikëqyrës përbëhet nga tre anëtarë.



6. Komisioni Mbikëqyrës ka obligim që së paku një herë në vit të mbikëqyrë financat dhe të përgatis raport të punës.
7. Komisioni Mbikëqyrës i SHS obligohet të informoj Komisioni Mbikëqyrës të NSKAP-it gjegjësisht Nivelin Sindikal Universitare për punën e vetë.

Neni 33

1. Mandati i Kryesisë së Shoqatës Sindikale dhe Komisionit Mbikëqyrës është katër vjet.
2. Kryetari i Shoqatës Sindikale zgjidhet me mandat 5 vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.
3. Puna e kryetarit, nënkryetarit e anëtarëve të kryesisë si dhe Komisionit Mbikëqyrës të Shoqatës Sindikale është vullnetare.
4. Kryetarin e SHS në rast të moszbatimit të vendimeve të organeve të SBASHK-ut apo shkeljeve statutore, përveç Kuvendit të SHS mund ta shkarkon edhe Kryetari i SBASHK-ut me vendim të vetin apo me propozimin e Kryetarit të NSKAP apo NSUSH.

NIVELI KOMUNAL

Neni 34

Niveli sindikal Komunal i Arsimit Parauniversitar (NSKAP) i SBASHK-ut përbëhet nga:

1. Kuvendi i NSKAP-it
2. Kryesia e NSKAP-it
3. Komisioni Mbikëqyrës i NSKAP-it

KUVENDI I NSKAP-it

Neni 35

1. Kuvendi i NSKAP-it përbëhet nga kryetarët e të gjitha Shoqatave Sindikale të Arsimit Parauniversitar të një komune.
2. Shoqatat Sindikale që kanë më tepër se 40 anëtarë edhe një anëtarë, e në rast se ka më tepër se 80 edhe dy anëtarë ku së paku njëri nga ta duhet të jetë i gjinisë femërore.
3. Anëtarët e Këshillit Drejtues të SBASHK-ut marrin pjesë në mbledhjet e Kuvendit të NSKAP të komunës që atapërfaqësojnë dhe e njoftojnë Kuvendin me vendimet dhe punën e KD.
4. Kuvendi duhet të mbledhet së paku tri herë në vit, por nëse është e nevojshme mund të thirret më shpesh.
5. Kuvendin e thërret kryetari, me kërkesën e 1/3- së të anëtarëve të Kuvendit apo Kryesisë së NSKAP-it.
6. Kuvendi i NSKAP-it, miraton rregullat dhe rregulloren e punës së kuvendit, miraton raportet e punës dhe raportin financiar të kryesisë, përcakton prioritetet e organizimit të aktiviteteve sindikaliste në nivel komune apo të përcaktuar nga niveli qendror.

Neni 36

Kuvendi i NSKAP-it e voton kryetarin e propozuar nga Kryesia e SBASHK-ut, zgjedh dhe shkarkon kryetarin, nënkryetarin, kryesinë e NSKAP-it, delegatët për Kongresin e SBASHK-ut nga komuna përkatëse, Komisionin Mbikëqyrës dhe komisione e përfaqësues tjerë, duke u bazuar në nevojën reale për funksionimin e tyre.

KRYESIA E SKAP-it

Neni 37

1. Kryetarin e NSKAP e propozon Kryesia e SBASHK-ut, ndërsa e voton Kuvendi i NSKAP me votim të fshehtë nëse ka kundërkandidat; në të kundërtën mund të votohet me votim të hapur, kandidat/e i/ e cila/i duhet të jetë anëtar/e i/e Kuvendit të NSKAP-it dhe të ketë përvojë në udhëheqje sindikale në nivel shoqate apo NSKAP së paku një mandat.
2. Nënkryetari dhe Anëtarët e Kryesisë zgjedhen nga Kuvendi NSKAP-it, nga radhët e anëtarëve të SBASHK-ut të komunës gjegjëse me votim të fshehtë ndërmjet dy ose më shumë kandidatëve.
3. Kandidatët nga pika 1 dhe 2 e këtij neni duhet të marrin mbi 50% të votave të anëtarëve të Kuvendit të NSKAP-it, e në rast se edhe pas raundit të tretë nuk arrijnë që të marrin më tepër se 50 % të votave, ndërpritet votimi dhe në një periudhë dyjavore propozohen kandidat tjerë.
4. Kryesia e NSKAP-it përbëhet nga 3-7 anëtarë, por jo me shume se 50% i numrit të shoqatave sindikale në atë komunë, dhe duhet të jenë të përfaqësuara të dy gjinitë.



## STATUTI I SBASHK-ut

5. Kryetari dhe nënkryetari i NSKAP-it duhet të jenë njëri nga arsimit parashkollor, fillor dhe i mesëm i ultë, e tjetri nga arsimit i mesëm i lartë si dhe së paku njëri nga ta të jetë i gjinisë femërore.
6. Kryetari përgatit raport pune dhe raport financiar dhe i raporton Kuvendit dhe Kryesisë së SBASHK-ut.
7. Kryetarin e NSKAP-it në rast të moszbatimit të vendimeve të organeve të SBASHK-ut apo shkeljeve statutores, e shkarkon me automatizëm kryetari i SBASHK-ut dhe e njofton kryesin NSKAP-it.
8. Mandati i autoritetit në nivel komunal është 5 vjet me mundësi rizgjedhjeje.

## KOMISIONI MBIKËQYRËS I NSKAP-it

### Neni 38

1. Komisioni Mbikëqyrës i NSKAP-it, mbikëqyrë përdorimin e fondeve financiare dhe të tjera dhe e informon Kuvendin dhe Kryesinë e NSKAP-it dhe Komisionin qendror mbikëqyrës të SBASHK-ut.
2. Komisioni Mbikëqyrës përbëhet nga anëtarët i zgjedhur nga Kuvendi i NSKAP-it.
3. Anëtari i Komisionit Mbikëqyrës nuk mund të jetë njëkohësisht anëtar i Kryesisë së NSKAP-it dhe anasjelltas dhe as kryetar i shoqatës sindikale
4. Kuvendi dhe Kryesia e NSKAP-it do të marrë në konsideratë raportet dhe konkluzionet e Komisionit Mbikëqyrës.
5. Komisioni Mbikëqyrës përbëhet nga tre anëtarë.
6. Komisioni Mbikëqyrës ka obligim që së paku një herë në vit të mbikëqyrë financat dhe të përgatis raport të punës.
7. Komisioni Mbikëqyrës i NSKAP-it, obligohet të informojë Komisionin Mbikëqyrës Qendror.

## NIVELI UNIVERSITAR

### Neni 39

Niveli sindikale Universitare ( NSU ) përbëhet nga:

1. Kuvendi i NSU-it
2. Kryesia a NSU-it
3. Komisioni Mbikëqyrës i NSU-it

## KUVENDI I NSU-it

### Neni 40

1. Kuvendi i NSU-it përbëhet nga kryetarët e të gjitha Shoqatave Sindikale të Universitetit përkatës.
2. Shoqatat Sindikale që kanë nga 40 - 80 anëtarë përfaqësohen në Kuvend edhe me një anëtar shtesë, ndërsa shoqatat që kanë më tepër se 80 anëtarë përfaqësohen edhe me dy anëtarë.
3. Anëtari i dytë dhe tretë i shoqatës sindikale që përfaqësohet në Kuvend nuk mund të jetë i të njëjtës gjini me kryetarin e asaj shoqate sindikale.
4. Me punën e Kuvendit udhëheq Kryetari.
5. Kuvendi duhet të mbledhet së paku tri herë në vit. Nëse është e nevojshme mund të thirret më shpesh.
6. Kuvendin e thërret kryetari, me kërkesën e 1/3- së të anëtarëve të Kuvendit apo Kryesisë së NSU-it, ose në rast se nuk thirret nga kryetari i NSU-it, kuvendin e thërret kryetari i SBASHK-ut.
7. Kuvendi i NSU-it miraton rregullat dhe rregulloren e punës së kuvendit, miraton raportet e punës dhe raportin financiar të Kryesisë ( nëse disponon fonde financiare ), përcakton prioritetet e organizimit të aktiviteteve sindikaliste në nivel tëuniversitetit apo të përcaktuar nga niveli qendror.

### Neni 41

Kuvendi i NSU-it zgjedh Kryesinë e NSU-it , delegatët për Kuvendin e NSUSH, dhe komisione e përfaqësues tjerë duke u bazuar në nevojën reale për formimin, gjegjësisht zgjedhjen e tyre.

## KRYESIA E SU-it

### Neni 42

1. Kryetari i NSU propozohet nga Kryesia e SBASHK-ut ; nënkryetari, dhe anëtarët e Kryesisë zgjidhen nga Kuvendi i NSU-it, nga radhët e anëtarëve të SBASHK-ut të universitetit gjegjësisht me votim të fshehtë, ndërmjet dy ose më shumë

- kandidatëve.
2. Kryesia e NSU-it, përbëhet nga 3-5 anëtarë varësisht nga numri i Shoqatave Sindikale në atë Universitet dhe duhet të jenë të përfaqësuar të dy gjinitë.
  3. Kryetari dhe Nënkryetari i NSU-it, preferohet të jenë njëri nga stafi akademik e tjetri nga stafi administrativ si dhe sëpaku njëri nga ta të jetë i gjinisë femërore.
  4. Përgatit raport pune dhe raport financiar ( nëse disponon fonde financiare ), dhe i raporton Kuvendit të NSU-it
  5. Mbledhjet e Kryesisë i thërret dhe udhëheq Kryetari i NSU-it.
  6. Kandidatët nga pika 1 dhe 3 të këtij neni duhet t'i marrin mbi 50% të votave të anëtarëve të Kuvendit të NSU; e në rasti se edhe pas raundit të tretë nuk arrijnë që të marrin më tepër se 50 % të votave, ndërpritet votimi dhe, në një periudhë dyjavore, propozohen kandidatë të tjerë.
  7. Mandati i autoritetit në nivel universitar është 5 vjet me mundësi rizgjedhjeje.

## KOMISIONI MBIKËQYRËS I SU-it

## Neni 43

1. Komisioni Mbikëqyrës i NSU-it, mbikëqyrë përdorimin e fondeve financiare, pasurinë sindikale, punën sindikale dhe është tjetra pasurore të NSU-it dhe e informon Kuvendin dhe Kryesinë e NSU-it.
2. Komisioni Mbikëqyrës përbëhet nga anëtarët e zgjedhur nga Kuvendi i NSU-it.
3. Anëtari i Komisionit Mbikëqyrës nuk mund të jetë njëkohësisht anëtar i Kryesisë së NSU-it dhe anasjelltas.
4. Kuvendi dhe Kryesia do të marrë në konsideratë raportet dhe konkluzionet e Komisionit Mbikëqyrës.
5. Anëtari i Komisionit Mbikëqyrës nuk mund të jetë njëkohësisht anëtar i Kryesisë së NSU-it dhe anasjelltas, dhe as kryetar i shoqatës sindikale.

## Neni 44

SBASHK-un në nivel qendrore organizohet në këtë mënyrë:

1. Niveli Sindikal i Arsimit Parafillor, Fillor dhe të Mesëm të Ulët i SBASHK-ut (NSAPF);
2. Niveli Sindikal i Arsimit të Mesëm e Lartë i SBASHK-ut (NSAM);
3. Niveli Sindikal i Universiteteve dhe e Shkencës i SBASHK-ut, në tekstin e mëtejme (NSUSH);
4. Niveli Sindikal i Kulturës i SBASHK-ut, në tekstin e mëtejme NSKK.

## Neni 45.

Mënyra e organizimit dhe veprimi i pjesëve përbërëse të SBASHK-ut rregullohet me këtë Statut

## Neni 46.

Niveli Sindikal i Arsimit Parafillor, Fillor dhe e Mesme e Ultë i SBASHK-ut (NSAPF) përbëhet nga:

1. Kuvendi i NSAPF
2. Kryesia e NSAPF

## KUVENDI I NSAPF

## Neni 47

1. Organi më i lartë i NSAPF është Kuvendi, i cili vepron në bazë të të drejtave dhe detyrimeve që dalin nga dokumentet e Kongresit, Këshillit Drejtues dhe Kryesia e SBASHK-ut.
2. Kuvendi i NSAPF përbëhet nga delegatët e Arsimit Parafillor, Fillor dhe të Mesëm të Ulët nga komunat e Kosovës, ku SBASHK-u ka anëtarësi. Të gjitha komunat në Kuvendin e NSAPF përfaqësohen me nga një delegat. Delegatët e NSAPF janë automatikisht kryetarët e NSKAP-it nëse janë të nivelit përkatës, ose në të kundërtën delegat është nënkryetari i atij niveli.
3. Delegatët duhet të jenë të përfaqësuar me të dy gjinitë dhe kanë mandat 5 vjeçar.
4. Me punën e Kuvendit udhëheq kryetari.
5. Kryetari i NSAPF propozohet nga Kryesia e SBASHK dhe votohet nga anëtarët e kuvendit të NSAPF. Nënkryetari, dhe anëtarët e Kryesisë zgjidhen nga Kuvendi i NSAPF, nga radhët e anëtarëve të SBASHK-ut.
6. Kryetari dhe nënkryetari i Kuvendit, janë kryetar përkatësisht nënkryetar të Kryesisë së NSAPF, ndërsa kryetari është edhe anëtar i Kryesisë së SBASHK-ut.
7. Kryetari i NSAPF për punën e vetë i përgjigjet kryetarit të SBASHK-ut dhe Kuvendit,



## STATUTI I SBASHK-ut

8. Kuvendin e thërret kryetari, me kërkesën e 1/3- së së anëtarëve të Kuvendit apo Kryesisë së NSAPF-së; ose, në rast se nuk thirret nga organet e veta, kuvendi thirret nga kryetari i SBASHK.
9. Kuvendi mund të punojë nëse në të marrin pjesë më shumë se 1/2 e anëtarëve të tij
10. Vendimet e Kuvendit janë të plotfuqishme nëse për të votojnë më shumë se gjysma e anëtarëve të pranishëm në Kuvend.
11. Kuvendi i NSAPF miraton rregullat dhe rregulloren e punës së kuvendit, miraton raportet e punës dhe raportin financiar të Kryesisë ( nëse disponon fonde financiare ), përcakton prioritetet e organizimit të aktiviteteve sindikaliste në nivel të universitetit apo të përcaktuar nga niveli qendror.

### Neni 48

Kuvendi i NSAPF zgjedh Kryesinë e NSAPF, dhe komisione e përfaqësues tjerë duke u bazuar në nevojën reale për formimin, gjegjësisht zgjedhjen e tyre.

## KRYESIA E NSAPF

### Neni 49

1. NSAPF e udhëheq Kryesia e përbërë pre 9 (nëntë) anëtarëve dhe duhet të jenë të përfaqësuara të dy gjinitë.
2. Kryesinë e NSAPF e përbëjnë përfaqësuesit e 7 rajoneve të propozuar nga delegatët e komunave të rajonit përkatës të cilët i zgjedh Kuvendi i NSAPF.
3. Në rast se njëri nga përfaqësuesit e rajoneve largohet nga Kryesia për shkaqe të ndryshme atëherë në Kryesi hyn kandidati tjetër i atij rajoni, që është në radhë për nga numri i votave të firmuara në Kuvendin zgjedhor.
4. Kandidatët nga neni 47, pika 5 e këtij neni duhet t'i marrin mbi 50% të votave të anëtarëve të Kuvendit të NSAPF, e në rast se edhe pas raundit të tretë nuk arrijnë të marrin më tepër se 50 % të votave, ndërpritet votimi dhe, në një periudhë dyjavore, propozohen kandidatët të tjerë.
5. Kryetari dhe nënkryetari i NSAPF duhet të jenë të regjioneve të ndryshme dhe së paku njëri nga ta të jetë i gjinisë femërore.
6. Kryesia e NSAPF miraton rregullat dhe rregulloren e punës së Kryesisë, miraton raportet e punës dhe raportin financiar ( nëse disponon fonde financiare ), përcakton prioritetet e organizimit të aktiviteteve sindikaliste në nivel të NSAPF, apo të përcaktuar nga SBASHK-u.

### Neni 50

Niveli Sindikal i Arsimit të Mesëm të Lartë i SBASHK-ut (NSAM) përbëhet nga:

1. Kuvendi i NSAM-it
2. Kryesia e NSAM-it

## KUVENDI I NSAM

### Neni 51

1. Organi më i lartë i NSAM është Kuvendi i cili vepron në bazë të të drejtave dhe detyrimeve që dalin nga dokumentet e Kongresit, Këshilli Drejtues dhe Kryesia e SBASHK-ut.
2. Kuvendin e NSAM-it e përbëjnë delegatët e arsimit të mesëm të lartë nga komunat e Kosovës, ku SBASHK-u ka anëtarësi. Delegatët e NSAM-it janë automatikisht kryetarët e NSKAP-it, nëse janë të nivelit përkatës, ose në të kundërtën, delegat është nënkryetari i atij niveli. Komunat që kanë delegat shtesë, anëtar duhet të jetë ndonjëri nga anëtarët e Kryesisë që është i nivelit përkatës.
3. Delegat të Kuvendit të NSAM janë edhe anëtarët e Kryesisë të NSAM.
4. Delegatët duhet të jenë të përfaqësuar me të dy gjinitë dhe kanë mandat 5 vjeçar.
5. Me punën e Kuvendit udhëheqë Kryetari
6. Kryetari i NSAM-it propozohet nga Kryesia e SBASHK-ut dhe votohet nga anëtarët e Kuvendit të NSAM-it. Nënkyetari, dhe anëtarët e Kryesisë zgjidhen nga Kuvendi i NSAM-it, nga radhët e anëtarëve të SBASHK-ut.
7. Kryetari dhe nënkryetari i Kuvendit janë Kryetar përkatësisht nënkryetar të Kryesisë së SAMK-së, ndërsa kryetari është edhe anëtar i Kryesisë së SBASHK-ut.
8. Kryetari i NSAM për punën e vetë i përgjigjet Kryetarit të SBASHK-ut dhe Kuvendit,
9. Kuvendin e thërret kryetari , me kërkesën e 1/3- së të anëtarëve të Kuvendit apo Kryesisë së NSAM.

10. Kuvendi mund të punoj nëse në të marrin pjesë më shumë se 1/2 e anëtarëve të tij
11. Vendimet e Kuvendit janë të plotfuqishme nëse për të votojnë më shumë se gjysma e anëtarëve të pranishëm në Kuvend.
12. Kuvendi i NSAM miraton rregullat dhe rregulloren e punës së kuvendit, miraton raportet e punës dhe raportin financiar të Kryesisë ( nëse disponon fonde financiare ), përcakton prioritetet e organizimit të aktiviteteve sindikaliste në nivel të universitetit apo të përcaktuar nga niveli qendror.

#### KRYESIA E NSAM

##### Neni 52

1. NSAM e udhëheq Kryesia e përbërë pre 9 (nëntë) anëtarëve dhe duhet të jenë të përfaqësuar të dy gjinitë.
2. Kryesinë e NSAM e përbëjnë përfaqësuesit e 7 rajoneve të propozuar nga delegatët e komunave të rajonit përkatësitë cilët i zgjedh Kuvendi i NSAM.
3. Në rast se njëri nga përfaqësuesit e rajoneve largohet nga Kryesia për shkaqe të ndryshme atëherë në Kryesi hyn kandidati tjetër i atij rajoni qe është në radhë për nga numri i votave të fituara në Kuvendin zgjedhor.
4. Kandidatët nga neni 51, pika 6 e këtij neni duhet t'i marrin mbi 50% të votave të anëtarëve të Kuvendit të NSPFK, e në rast se edhe pas raundit të tretë nuk arrijnë që të marrin më tepër se 50 % të votave, ndërpritet votimi dhe, në një periudhë dyjavore, propozohen kandidatët të tjerë.
5. Kryetari dhe nënkryetari i NSAM preferohet të jenë të regjioneve të ndryshme dhe së paku njëri nga ta të jetë i gjinisë femërore.
6. Kryesia e NSAM miraton rregullat dhe rregulloren e punës së Kryesisë, miraton raportet e punës dhe raportin financiar ( nëse disponon fonde financiare ), përcakton prioritetet e organizimit të aktiviteteve sindikaliste në nivel të SAPFK-së apo të përcaktuar nga SBASHK-ut.

##### Neni 53

Niveli Sindikal i Universiteteve dhe i Shkencës i SBASHK-ut, në tekstin e mëtejshëm (NSUSH) përbëhet nga:

1. Kuvendi i NSUSH -it;
2. Kryesia e NSUSH -it;
3. Komisioni Mbikëqyrës i NSUSH-it;

#### KUVENDI I NSUSH-it

##### Neni 54

1. Organi më i lartë i NSUSH-it është Kuvendi, i cili vepron në bazë të të drejtave dhe detyrimeve që dalin nga dokumentet e Kongresit, Këshilli Drejtues dhe Kryesia e SBASHK-ut.
2. Kuvendi është organi më i lartë i NSUSH Kuvendin e përbëjnë delegatët e zgjedhur të të gjitha Universitet dhe institucionet shkencore, anëtare të SBASHK-ut.
3. Delegatët për Kuvendin e NSUSH zgjidhen nga Kuvendet e Sindikatave të Universiteteve gjegjësisht Institucionet Shkencore dhe atë në çdo 40 anëtarë një delegatë.
4. Statusin e delegatit në Kuvendin e NSUSH e kanë edhe anëtarët e kryesisë së NSUSH, dhe kryetari i Komisionit Mbikëqyrës.
5. Me punën e Kuvendit udhëheq Kryetari, Nënkyetari dhe Sekretari i NSUSH.
6. Kryetari i NSUSH-it propozohet nga Kryesia e SBASHK-ut dhe votohet nga anëtarët e Kuvendit të NSUSH-it. Nënkyetari dhe anëtarët e Kryesisë zgjidhen nga Kuvendi i NSUSH-it, nga radhët e anëtarëve të SBASHK-ut.
7. Kuvendi zgjedh delegatët e NSUSH për Kongresin e SBASHK-ut.
8. Kryetari dhe Nënkyetari i Kuvendit, janë kryetar përkatësisht nënkryetar të Kryesisë së NSUSH, ndërsa kryetari është edhe anëtar i Kryesisë së SBASHK-ut.
9. Kryetari i NSUSH për punën e vetë i përgjigjet Kryetarit të SBASHK-ut dhe Kuvendit.
10. Kuvendin e thërret kryetari, me kërkesën e 1/3- së të anëtarëve të Kuvendit apo Kryesisë së NSUSH.
11. Kuvendi mund të punoj nëse në të marrin pjesë më shumë se 1/2 e anëtarëve të tij.
12. Vendimet e Kuvendit janë të plotfuqishme nëse për të votojnë më shumë se gjysma e anëtarëve të pranishëm në Kuvend.
13. Kuvendi, nëpërmjet udhëheqësisë dhe organeve të tij, për shumë çështje me interes për anëtarët, bashkëpunon dhe koordinon punën me asociacionet e ndryshme edukative-arsimore dhe shkencore.
14. Me punën e Kuvendit udhëheq Kryetari.



Neni 55

1. Kryesia e NSUSH përbëhet nga 11 ( njëmbëdhjetë ) anëtarë: Kryetari, Nënkryetari, Sekretari dhe shtatë anëtarë të Kryesisë janë Kryetarët e Niveleve sindikale të Universiteteve dhe një Kryetar i Institucioneve shkencore.
2. Në kryesi duhet të përfaqësohen të dy gjinitë.
3. Takimet e Kryesisë i thërret dhe i udhëheq Kryetari i NSUSH.
4. Kandidatët nga Neni 54, pika 6 e këtij neni duhet t'i marrin mbi 50% të votave të anëtarëve të Kuvendit të NSPF, e në rast se edhe pas raundit të tretë nuk arrijnë që të marrin më tepër se 50 % të votave, ndërpriet votimi dhe, në një periudhë dyjavore, propozohen kandidatë të tjeë.
5. Kryesia e NSUSH miraton rregullat dhe rregulloren e punës së Kryesisë, miraton raportet e punës dhe raportin financiar, përcakton prioritetet e organizimit të aktiviteteve sindikaliste në nivel të NSUSH, apo të përcaktuar nga SBASHK-u.

KOMISIONI MBIKËQYRËS I NSUSH

Neni 56

6. Komisioni Mbikëqyrës i NSUSH, mbikëqyrë përdorimin e fondeve financiare dhe të tjera dhe e informon Kuvendindhe Kryesinë e NSUSH.
7. Komisioni Mbikëqyrës përbëhet nga anëtarët e emëruar nga Kuvendi i NSUSH.
8. Anëtari i Komisionit Mbikëqyrës nuk mund të jetë njëkohësisht anëtar i Kryesisë së NSUSH dhe anasjelltas.
9. Kuvendi dhe Kryesia e NSUSH do të marrë në konsideratë raportet dhe konkluzionet e Komisionit Mbikëqyrës.
10. Komisioni Mbikëqyrës përbëhet nga tre anëtarë.
11. Komisioni Mbikëqyrës ka obligim që së paku një herë në vit të mbikëqyrë financat dhe të përgatis raport të punës.
12. Anëtari i Komisionit Mbikëqyrës nuk mund të jetë njëkohësisht anëtar i Kryesisë së NSUSH-it dhe anasjelltas, dhe as kryetar i shoqatës sindikale.

VIII ORGANET E SBASHK-ut

Neni 57

1. Kongresi
2. Këshilli Drejtues ( KD)
3. Kryetari
4. Sekretari i Përgjithshëm
5. Kryesia
6. Komisioni Mbikëqyrës
7. Komisioni Statutor

KONGRESI

Neni 58

Organi më i lartë i SBASHK-ut është Kongresi.

Kongresi është i përbërë nga delegatët, anëtarë të SBASHK-ut, që zgjidhen duke u bazuar në numrin e anëtarëve që paguajnë kuotë sindikale dhe atë:

1. Për çdo 250 anëtarë nga një delegat.
2. Statusin e delegatit në Kongres e kanë edhe: Anëtarët e Kryesisë së SBASHK-ut, anëtarët e KD, Kryetari i Komisionit Mbikëqyrës, Kryetari i Komisionit Statutor dhe Menaxheri i Financave, pa të drejtën e votës, për raportin e punës dhe sanksionet e organeve në të cilat ata janë anëtarë.
3. Mandati i delegatit është pesë vjeçar.
4. Kongresi i rregullt mbahet çdo 5 vjet.
5. Kongresi i jashtëzakonshëm, nëse është e nevojshme, mund të mbahet më parë, me kërkesën e 1/3 të delegatëve të Kongresit, me vendim të KD, me vendim të Kryesisë ose Kryetarit të SBASHK-ut.
6. Vendimi për të thirr Kongresin, për kriteret e përzgjedhjes dhe numrin e delegatëve, e merr KD në pajtim me statutin.
7. Me punimet e Kongresit udhëheqin Kryetari, Sekretari i Përgjithshëm, Nënkryetari dhe dy anëtarë të zgjedhur në Kongres si kryesi e punës.
8. Në Kryesinë e punës të Kongresit Zgjedhor, në fazën e zgjedhjeve, nuk mund ta udhëheq ai që është kandidat për t'u zgjedhur në ndonjë post në Organet Udhëheqëse Qendrore të SBASHK-ut.
9. Të gjitha forumet, Kuvendet, Kongresi, Këshilli Drejtues, Kryesia, komisionet mund të mbahen me prezencë fizike, në distancë (online) ose edhe të kombinuara.

## Neni 59

Kongresi:

1. Miraton ndryshimet dhe plotësimet e Statutit dhe Programit të SBASHK-ut;
2. Miraton ndryshimet dhe plotësimet e parimeve dhe objektivave të SBASHK-ut;
3. Miraton, plotëson apo i anulon vendimet e KD;
4. E zgjedh ose e shkarkon Kryetarin dhe Sekretarin e Përgjithshëm të SBASHK-ut.
5. I zgjedh ose i shkarkon Anëtarët e Komisionit Mbikëqyrës dhe Komisionit Statutor;
6. Miraton raportin e punës dhe atë financiar të SBASHK-ut mes dy Kongreseve;
7. Diskuton dhe miraton raportin e Komisionit Mbikëqyrës.
8. Verifikon miratimin e shpenzimeve të miratuara nga Kryesia mes dy kongreseve (për 5 vite);
9. Miraton planifikimin e buxhetit afatmesëm (për 5 vite) mes dy kongreseve;
10. Përcakton drejtimit e veprimtarisë sindikale për periudhën mes dy Kongreseve;
11. Shqyrton vendimin e KD për hyrjen apo daljen e SBASHK-ut nga ndonjë Konfederatë;
12. Shqyrton ankesat dhe parashtrirat që i janë drejtuar Kongresit;
13. Miraton rregulloren e punës së Kongresit;
14. Mund të ndryshojë, ose anulojë ndonjë akt normativ apo vendim të Organeve të SBASHK-ut;
15. Zgjedh dy anëtarë të Komisionit të Punës së Kongresit.
16. Zgjedh Komisionet Verifikuese të Kongresit;
17. Miraton Zgjedhjen e Komisionin Kandidues të Kongresit të zgjedhur nga KD;
18. Zgjedh Komisionin Zgjedhor të Kongresit;
19. Zgjedh edhe Komisione tjera të nevojshme për punën e Kongresit;
20. Verifikon anëtarët e KD-së sipas propozimit të NSKAP, NSUSH dhe NSK;
21. Nxjerr rezoluta të cilat duhet të zëtohen nga organet tjera të SBASHK-ut.

## Neni 60

Kongresi për funksionimin më efikas të SBASHK-ut mund të transferojë te Këshilli Drejtues i SBASHK-ut, Kryetari apo Kryesia disa kompetenca brenda fushëveprimit të Kongresit.

## KËSHILLI DREJTUES

## Neni 61

Këshilli Drejtues i SBASHK-ut ( në tekstin e mëtejshëm KD ) është organi më i lartë i SBASHK-ut në mes dy Kongreseve.

1. KD-në e përbëjnë: Kryesia e SBASHK-ut, Kryetar i NSKAP dhe anëtarët e zgjedhur me propozimin e NSKAP-it të komunës përkatëse apo NSUSH, sipas këtij kriteri: Deri në 600 anëtarë - Kryetari i NSKAP-it apo nënkryetari i NSUSH, nga 600-1200 anëtarë, - edhe një delegat, nga 1200-1800 anëtarë edhe dy delegatë ku së paku njëri duhet të jetë i gjinisë femërore, dhe mbi 1800 anëtarë edhe tre delegatë, ku së paku dy nga ta të jenë të gjinisë femërore, e duke



ruajtur përfaqësimin e nivelit arsimor.

2. Në KD përfaqësohen edhe Shtëpitë Studentore një përfaqësues dhe Kultura me dy përfaqësues.
3. Anëtarët e KD i verifikon Kongresi sipas propozimit të NSKAP-it, NSUSH dhe NSK bazuar paragrafin 2.
4. KD e thërret Kryetari ose Kryesia e SBASHK-ut.
5. Mbledhja konstituive e KD duhet të thirret brenda 45 ditëve pas Kongresit.
6. KD thirret të paktën një herë në vit, por sipas nevojës edhe më shpesh.
7. KD mund të thirret edhe me kërkesën e 1/3 të anëtarëve të KD-së apo me kërkesën e Komisionit Mbikëqyrës. Punimet e KD-së i udhëheq Kryetari ose Sekretari i Përgjithshëm.

#### Neni 62

Këshilli Drejtues:

1. Verifikon draft-statutin e SBASHK-ut, nëse ka propozime gjatë diskutimit publik dhe ja paraqet Komisionit Statutor;
2. Verifikon projekt- programet e veprimit sindikal të SBASHK-ut.
3. Vlerëson, shqyrton dhe merr qëndrim lidhur me raportin njëvjeçar të punës së SBASHK-ut;
4. Vendors mbi nënshkrimin e Marrëveshjeve Sociale, Kontratës Kolektive dhe deklaratave në përputhshmëri me aktet ligjore;
5. Vlerëson, shqyrton dhe merr qëndrim lidhur me vendimet e Kryesisë së SBASHK-ut;
6. Miraton dhe ndryshon programin vjetor të punës dhe buxhetin për vitin paraprak dhe raporton mbi zbatimin e programit vjetor të punës dhe planit financiar, nëse i është bartur autorizimi nga Kongresi;
7. Cakton datën e mbajtjes dhe rendin e ditës së Kongresit sipas propozimit të Kryetarit apo Kryesisë;
8. Verifikon propozimin e Kryesisë për Komisionin Mbikëqyrës dhe Komisionin Statutor;
9. Propozon kandidatët për organet punuese të Kongresit;
10. Zgjedh Komisionin kandidues të Kongresit;
11. Vendors mbi anëtarësimin apo ç'anëtarësimin e SBASHK-ut në Konfederatë sipas propozim të Kryetarit;
12. Vendors në rast të konfliktit ndërmjet vendimeve të SBASHK-ut, përveç në lidhje me vendimet e Kongresit, Komisionit Mbikëqyrës dhe Komisionit Statutor;
13. Zgjedh nënkryetarin/ët, dhe zëvendëssekretarin e Përgjithshëm sipas propozimit të Kryetarit, gjegjësisht Sekretarit të Përgjithshëm.
14. Miraton rregulloren e punës së KD;
15. E informon anëtarësinë në lidhje me vendimet dhe veprimet e KD;
16. Organizon veprime të përbashkëta të solidaritetit që adresojnë çështjet sociale të punonjësve;
17. Kujdeset për mbrojtjen e plotë të anëtarëve të SBASHK-ut;
18. Merr masa ( rregullisht dhe tërësisht ) për anëtarësim në SBASHK, për pagesën e kuotës sindikale si dhe për sigurimin dhe mbarëvajtjen e fondeve në të gjitha nivelet e organizimit të SBASHK-ut;
19. Organizon forma të ndryshme të veprimit sindikal për të drejtat e anëtarëve të garantuara me Kushtetutë dhe Konventa Ndërkombëtare si dhe greva në nivel kombëtar;
20. Vendors për themelimin e kompanisë, organizatës, nxjerrjen e gazetës, revistës apo koleksionit të SBASHK-ut;
21. Kryen edhe aktivitete të tjera me interes për anëtarët e SBASHK-ut.

#### Neni 63

1. KD, për funksionimin efikas të SBASHK-ut mund të transferojë te Kryetari apo Kryesia e SBASHK-ut disa kompetenca brenda fushëveprimit të KD.
2. Anëtarët e KD-së, të cilët nuk marrin pjesë në dy mbledhje radhazi dhe mungesën e tyre nuk e arsyetojnë, zëvendësohen me automatizëm nga anëtarët rezervë të komunës përkatëse.

#### Neni 64

Kur kërkesat e arsyeshme të anëtarëve të saj, nuk zgjidhen përmes dialogut dhe veprimeve tjera sindikale;

1. KD i fton shoqatat sindikale, në përputhshmëri me Ligjet dhe Statutin, të ndërrojnë formën e deritashme të veprimit sindikal për të mbrojtur të drejtat e tyre dhe të përgatiten që të fillojnë grevën e përgjithshme.
2. KD shpall grevë të përgjithshme në përputhje me Ligjet në fuqi me 2/3 e votave të anëtarëve të KD përveç, nëse paraprakisht për grevë janë deklaruar mbi 50% e anëtarësisë e në këtë rast Kryetari i SBASHK-ut e merr vendimin për grevë.

KD thërret një Kongres të jashtëzakonshëm të SBASHK-ut në qoftë se për të deklarohen të paktën 2/3 të anëtarëve të KD.

### KRYESIA E SBASHK-ut ( Kryesia )

#### Neni 66

1. Kryesia përbëhet nga 7 ( shtatë ) anëtarë: Kryetari, Nënkryetari, Sekretari i Përgjithshëm, një përfaqësues për Arsimin Parashkollor, Fillor e i Mesëm i Ultë, një nga Arsimi i Mesëm i Lartë, një nga Arsimi Universitar dhe Shkenca dhe një nga Kultura.
2. Në kryesi duhet të përfaqësohen të dy gjinitë.
3. Takimet e Kryesisë i thërret dhe i udhëheq Kryetari i SBASHK-ut.
4. Niveli Arsimor që ka më pak se 1000 anëtarë nuk përfaqësohet në Kryesi, përveç nëse Kryetari i Nivelit Arsimor shkon me automatizëm.
5. Përfaqësuesit e Niveleve Arsimore dhe Kulturës në Kryesinë e SBASHK-ut janë vullnetar.

#### Neni 67

1. Kryetari, Nënkryetari dhe Sekretari i Përgjithshëm zgjidhen duke e respektuar nenin 67 dhe 85 .
2. Kryetari dhe nënkryetari nuk mund të jenë të njëjtës gjini.
3. Kryetarin dhe Sekretarin e Përgjithshëm i zgjedh Kongresi mes së paku dy kandidatëve, ndërsa Nënkryetarin dhe Zëvendëssekretarin e Përgjithshëm i zgjedh KD, të propozuar nga Kryetari i SBASHK-ut, gjegjësisht Sekretari i Përgjithshëm dhe kanë mandat 5-vjeçar.
4. Kandidatët për Kryetar dhe Sekretar të Përgjithshëm duhet të paraqesin para Kongresit programin e punës për mandatin që dëshirojnë të zgjidhen.
5. Kandidatët për Nënkryetar dhe Zëvendëssekretar të Përgjithshëm duhet të paraqesin para KD-së programin e punës për mandatin që dëshirojnë të zgjidhen.
6. Nënkryetari dhe Zëvendëssekretari i Përgjithshëm mund të pushohen përkohësisht nga detyra nga Kryetari i SBASHK-ut, përkatësisht Sekretari i Përgjithshëm, ku pastaj paraqesin në KD kërkesën për shkarkim në rast të moskryerjes së detyrave që ja përcakton statuti apo të moszbatimit të vendimeve të Kryetarit, Kryesisë apo KD-së.

#### Neni 68

##### Kryesia:

1. Zbaton vendimet e Kongresit dhe KD;
2. Monitoron dhe vlerëson zbatimin e marrëveshjeve shoqërore, Kontratës Kolektive, ligjeve dhe akteve të tjera ligjore;
3. Vendos për mjetet dhe procedurat e tjera në mungesë të marrëveshjeve shoqërore, kontratës kolektive, ligjeve dhe akteve të tjera ligjore;
4. Vendos për thirrjen e mbledhjeve të KD, përgatit dhe zbaton vendimet e KD;
5. Miraton, Rregullat e Punës së Kryesisë,
6. Miraton raportin e shpenzimeve vjetore të bazuar në planifikimin e miratuar nga Kongresi e të propozuar nga Kryetari;
7. I raporton KD për punën e vet;
8. Miraton rregullore dhe dokumente tjera relevante për aktivitetet e SBASHK-ut;
9. Miraton rregulloren e përgjithshme mbi të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës për punonjësit në të gjitha nivelet e organizimit të sindikatave;
10. Miraton rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës në SBASHK dhe rregullore tjera;
11. Cakton vlerën e poenit për paga;
12. Propozon krijimin e veb-faqes, botimin e revistave, broshurave, etj;
13. Kujdeset për personelin profesional, kadrovik dhe çështje të tjera për punën dhe aktivitetet e SBASHK-ut;
14. Kujdeset për pronat e blera nga fondet në përputhje me rregullat e ndarjes së tarifave;
15. I propozon KD planin vjetor dhe plotësim ndryshimin e planit financiar të miratuar në Kongres sipas nevojës;
16. Merr vendime dhe jep udhëzime për krijimin dhe mbajtjen e kontakteve me autoritetet shtetërore qendrore, lokale, joqeveritare dhe ndërkombëtare, si dhe persona të tjerë juridik në fushën e arsimit;
17. Emëron dhe shkarkon grupe punuese për të negociuar dhe lidhur marrëveshje kolektive, si dhe ua jep atyre



- udhëzimet e duhura për negociatat;
18. Propozon shkarkimin e Kryetarit të NSKAP, NSUSH e NSK, në rast të shkeljeve statutore apo moszbatimit të vendimeve të organeve të SBASHK-ut, të Kryetarit të SBASHK-ut apo të organet që i kanë zgjedhur.
  19. I propozon KD veprim të rregullt dhe të plotë për anëtarësim të anëtarëve, pagesa të kuotës apo politikat destinuese për përdorimin e fondeve të sindikatave;
  20. Bashkëpunon me institucionet e përfaqësuesit sindikal dhe koordinon punën e niveleve komunale të SBASHK-ut,
  21. Vendosi dhe mban kontakte me sindikatat e tjera në të gjitha fushat;
  22. Vendosi për propozime, për të ngritur procedura para Gjykatës Kushtetuese;
  23. Shqyrton dhe merr vendime lidhur me iniciativat dhe propozimet e anëtarëve dhe organeve të tjera të sindikatave;
  24. Emëron përfaqësuesit e SBASHK-ut në organe dhe tjera;
  25. Jep opinion mbi ligjet, rregulloret dhe dokumentet e tjera;
  26. Miraton vendime të tjera në kuadër të statutit.

## KRYETARI

Neni 69

1. Përfaqëson SBASHK-un;
2. Përfaqëson interesat e anëtarëve para autoriteteve dhe institucioneve dhe në takimet sindikale ndërkombëtare;
3. Thërret seanca dhe kryeson punën e KD dhe Kryesisë;
4. Zbaton vendimet, rezolutat dhe konkluzionet e Kongresit, KD dhe Kryesisë;
5. Miraton raportet vjetore financiare sipas planifikimit të miratuare në Kongres dhe i paraqet për miratim në Kryesi;
6. Miraton Planifikimin buxhetor vjetor duke u bazuar në planifikimin e miratuar nga Kongresi;
7. Merr masa të nevojshme për zbatimin e politikave të përcaktuara nga SBASHK-u;
8. Në mbledhjet e KD dhe Kryesisë raporton për punën, aktivitetet dhe realizimin e vendimeve;
9. Siguron zbatimin e vendimeve të KD dhe Kryesisë;
10. Nënshkruan Kontratën Kolektive për sektorin e arsimit;
11. Nënshkruan kontrata të treta, në interes të SBASHK-ut sipas vendimeve të KD apo Kryesisë;
12. Nënshkruan planifikimin buxhetor 5- vjeçar të miratuar nga Kongresi dhe kujdeset për implementimin e tij.
13. Është përgjegjës për bashkëpunim të drejtpërdrejtë me sindikatat e tjera në Republikën e Kosovës dhe vende të tjera.
14. Udhëheq bashkëpunimin sindikal ndërkombëtar;
15. Kujdeset për edukimin e rregullt të sindikalistëve dhe zyrtarëve të tjerë të sindikatave;
16. Është përgjegjës i fondeve në llogaritë të SBASHK-ut;
17. Obligohet që të informoj anëtarësinë dhe opinionin publik për të gjitha vendimet e Organeve të SBASHK-ut; Mban takime të rregullta me Kryetarët e NK të Arsimit Parauniversitar dhe atij Universitar;
18. Vendosi për të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e udhëheqësve në SBASHK, në të gjitha nivelet e organizimit;
19. Vendosi për çështje të tjera në përputhje me këtë Statut dhe vendimet e KD dhe Kryesisë;
20. Emëron dhe shkarkon Këshilltarët për organizim të brendshëm dhe bashkëpunim ndërkombëtar;
21. Propozon kandidat për Nënkryetar, Kryetar të nivelit komunale të arsimit parauniversitar, nivelit të mesëm të lartë, të universiteteve.
22. Emëron komisione të ndryshme për punën në SBASHK;
23. Shkarkon cilindo nga udhëheqësit e zgjedhur nga shoqata sindikale deri në nivel Qendror, përveç anëtarëve të Komisionit Mbikëqyrës dhe Komisionit Statutor, në rast të shkeljeve Statutore apo moszbatimit të vendimeve të organeve të SBASHK-ut;
24. Përjashton nga SBASHK-u, anëtarin e SBASHK-ut në rastin kur shkel vendimet e organeve të SBASHK-ut ose në mënyrë publike propagandon kundër SBASHK-ut me qëllim të dëmtimit të SBASHK-ut;
25. Plotëson përbërjen e Komisionit Mbikëqyrës dhe Komisionit Statusor në rast se mbetet i zbrazët vendi në komision.
26. I raporton për punën e vet, Kryesisë, KD dhe Kongresit.

## NËNKRYETARËT

Neni 70

1. Në bashkëveprim me kryetarin, kryejnë të gjitha punët dhe detyrat që i angazhon Kryesia dhe Kryetari;
2. Për punën e vetë i përgjigjet Kryetarit dhe KD;
3. Detyrat e veçanta që kryejnë nënkryetarët dhe anëtarët e Kryesisë nga nivelet arsimore duhet të përcaktohen me rregullore të Kryesisë.

## SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

## Neni 71

1. Organizon, dhe është përgjegjës-e për përgatitjen e materialeve për mbledhjet e KD, komisioneve dhe organeve nën mbikëqyrjen e KD;
2. Organizon punët për përgatitjen e mbledhjeve të Kryesisë;
3. Organizon dhe koordinon punën e grupeve punuese;
4. Kujdeset për shqyrtimin e kërkesave, njofton palët me qëndrimet e KD apo Kryesisë dhe detyra tjera;
5. Informon anëtarët e SBASHK-ut dhe i udhëzon për punë në të gjitha nivelet e organizimit në pajtueshmëri me vendimet e KD apo Kryesisë së SBASHK-ut;
6. Krijon dhe mban kontakte me sindikat ndërkombëtare në pajtueshmëri me vendimet e KD apo Kryesisë së SBASHK-ut
7. Ju ofron asistencë dhe trajnime sindikale të nevojshme udhëheqësve sindikalë nga shoqata sindikale, nivelet komunale, nivelet arsimore dhe kryesis së SBASHK-ut.
8. Koordinon punën me Kryetarët e Sindikatave Komunale, me Arsimin Parauniversitar, Universitar, Shkencën e Kulturën për mbajtjen e Kuvendeve;
9. Asiston me zyrtarët për financa për të kryer planin financiar.
10. Është përgjegjës/e për të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e të punësuarve në SBASHK;
11. Nënshkruan kontratat e të punësuarve në SBASHK dhe mbikëqyr implementimin e kontratave të lidhura nga SBASHK me operatorë të tjerë.
12. Koordinon punët me juristin për përfaqësimin e SBASHK-ut në kontestet Gjyqësore;
13. Udhëheq diskutimet dhe negociatat me organizatat e tjera përveç nëse Kryesia vendos ndryshe;
14. Formulohet në këtë formë: I propozon KD-së propozimin për zëvendëssekretar të përgjithshëm.
15. Kryen edhe punë të tjera në përputhje me statutin dhe dokumentet e tjera të SBASHK-ut.

## Neni 72

Kryetari dhe nënkryetari duhet të jenë të liruar nga obligimet e punës primare në ndonjë institucion tjetër gjatë mandatit, ndërsa sekretari i përgjithshëm me vetëdëshirë, mund ta liroj vendin e punës primare.

## Neni 73

1. Kryetarit, Nënkryetarit, Sekretarit të Përgjithshëm, Anëtarëve të Kryesisë dhe të gjithë personave të zgjedhur në të gjitha nivelet, i pushon detyra më:
  - 1.1. Përfundim të mandatit;
  - 1.2. Pensionim (mosha 65 vjeç sipas Ligjit të Punës Nr.03/L-212);
  - 1.3. Shkelje të rëndë të Statutit;
  - 1.4. Shkarkimin nga Kryetari i SBASHK-ut apo nëse deklarohen të paktën 50%+1 të anëtarëve të Organit që e ka zgjedhur;
  - 1.5. Dorëheqje;
2. Përjashtimisht nga pika 1.2 bëjnë nëse kanë kaluar më tepër se 2/3 e mandatit të cilin mund ta vazhdojnë mandatin deri në Kongresin e rregullt zgjedhor.

## Neni 74

1. Në rastet kur Kryetari nuk është në gjendje të kryejë funksionin e tij, funksionin e kryetarit e kryen Nënkryetari;
2. Në rastet e parashikuara në nenin 73, pika 1.2, 1.3, 1.4 1.5 dhe 1.6 të Statutit, deri në zgjedhjen e Kryetarit të ri, ushtrues i detyrës është nënkryetari;  
Zgjedhja e Kryetarit, sipas paragrafit 1. 2 të këtij neni, duhet të bëhet brenda 6 muajve;
3. E njëjta procedurë vlen edhe për Nënkryetar, Sekretarin e Përgjithshëm e Anëtarët e Kryesisë;
4. Kryetari, Nënkryetarët, Sekretarin e Përgjithshëm e Anëtarët e Kryesisë të zgjedhur kanë mandat deri në Kongresin e rregullt zgjedhor.

## KOMISIONI MBIKËQYRËS

## Neni 75

1. Komisioni Mbikëqyrës, mbikëqyrë ligjshmërinë e financimit, alokimin dhe përdorimin e fondeve të SBASHK-ut;
2. Komisioni Mbikëqyrës, përbëhet prej tre anëtarëve të cilët në mbledhjen konstituive zgjedhin kryetarin;



3. Anëtarët e Komisionit Mbikëqyrës, nuk mund të jenë anëtarë të KD, e as të Kryesisë;
4. Komisioni Mbikëqyrës, do të veprojë me nismën e vet, me iniciativën e KD, Kryesisë dhe Kryetarit;
5. Komisioni Mbikëqyrës është i pavarur në punën e tij;
6. Dokumentet e Komisionit Mbikëqyrës janë: mendimet interpretimet dhe vendimet.
7. Komisioni Mbikëqyrës, miraton rregullat e veta të procedurës.
8. Monitoron zbatimin e politikave të përcaktuara financiare, kontrollon dhe shqyrton se si bëhet grumbullimi i të hyrave;
9. Kontrollon menaxhimin e përgjithshëm financiar të SBASHK-ut se a është në përputhje me planifikimin;
10. I raporton Kryesisë, KD dhe Kongresit;
11. Nëse konstaton parregullsi mund të kërkojë thirrjen e Kryesisë apo KD;
12. Ka qasje në të gjitha dokumentet ligjore të SBASHK-ut dhe organet e tij, në të gjitha nivelet e organizimit, të cilat janë të lidhura me realizimin e objektivave të Komisionit Mbikëqyrës;
13. Anëtarët e Komisionit Mbikëqyrës do të zgjidhen për një mandat prej 5 vjetësh;
14. Anëtarët e Komisionit Mbikëqyrës janë vullnetarë;
15. Analizon raportet e komisioneve mbikëqyrëse nga nivelet komunale. Kujdeset që puna e komisioneve mbikëqyrëse të jetë në përputhje me statutin.

## KOMISIONI STATUTOR

## Neni 76

1. Komisioni Statutor e interpreton Statutin dhe dokumentet tjera të SBASHK-ut;
2. Përkujdeset që rregulloret e punës dhe rregulloret e tjera të niveleve komunale dhe shoqatave sindikale të jenë në harmoni me Statutin e SBASHK-ut;
3. Komisioni Statutor mbikëqyr punën e zgjedhjeve në të gjitha nivelet e SBASHK-ut;
4. Komisioni Statutor zgjidh ankesat e anëtarëve, shoqatave sindikale, niveleve komunale apo organeve tjera brenda SBASHK-ut në lidhje me:
  - 4.1 Shkeljen e procesit zgjedhor;
  - 4.2 Anulimin e zgjedhjeve sindikale;
  - 4.3 Shkeljen e Statutit;
  - 4.4 Shkarkimin dhe dorëheqjen;
5. Komisioni Statutor merr vendime në mbledhjen e tij brenda 30 ditëve nga marrja e ankesës në procedurë të rregullt;
6. Komisioni miraton rregulloren e punës;
7. Dokumentet që nxjerrë Komisioni Statutor janë konkluzionet dhe vendimet;
8. Dokumentet janë përfundimtare dhe të detyrueshme në qoftë se për ta nuk parashtrahet ankesë brenda afatit të parashikuar;
9. Komisioni statutor ka 5 anëtarë. Në mesin e anëtarëve zgjidhet Kryetari. Zgjedhja e anëtarëve të Komisionit Statutor do të jetë me votim të fshehtë me kundër kandidat në Kongres;
10. Anëtarët e Komisionit Statutor zgjidhen për një mandat prej 5 vjetësh;
11. Anëtarët e Komisionit Statutor janë vullnetarë;

## Neni 77

## VENDIMMARRJA NË SBASHK

1. Kushti themelor për të vendosur në Shoqata Sindikale dhe në të gjitha organet e SBASHK-ut është shprehja e vullnetit në mënyrë demokratike, në interes të anëtarësisë.
2. Organet e shoqatave sindikale, nivelit komunal, niveleve arsimore dhe të SBASHK-ut mund ligjërisht të vazhdojnë punën nëse në seancë marrin pjesë shumica e anëtarësisë të përgjithshme dhe vendimet janë të vlefshme, në qoftë se ato janë marrë me votimin e shumicës së të pranishmëve, përveç nëse ndonjë nen i statutit për ndonjë organ të caktuar e parasheh ndryshe.
3. Të gjitha organet e SBASHK-ut para marrjes së vendimeve, qëndrimeve dhe konkluzioneve për çështjet më vitale të veprimtarisë së tij si dhe në dokumentet e karakterit programor dhe statutor, duhet të organizojnë një debat publik me anëtarësinë.
4. Vendimet merren me votim, në përputhje me statutin.

STATUTI I SBASHK-ut  
PROCEDURAT E KANDIDATURËS

2025

Neni 78

1. SBASHK-u është i pavarur në menaxhimin e politikës së kuadrove të tij.
2. Anëtar i SBASHK-ut ka të drejtën e vetëkandidimit, mund të zgjedhë dhe të propozojë, të jetë i propozuar dhe i zgjedhur në kuvendet ose forume në të cilat është i deleguar, përveç për pozitën në të cilat të drejtën e propozimit e ka ekskluzivisht kryesia e SBASHK-ut.
3. Për propozimin dhe kryerjen e ndonjë funksioni në Sindikatë, anëtar duhet të paraqes kandidaturën me shkrim.
4. Çdo kandidat i propozuar duhet të deklarohet për pranimin e kandidimit, i cili pastaj fiton të drejtën që të futet në listën e kandidatëve.

Neni 79

1. Nëse zgjedhjet në Shoqatat Sindikale, nivelin komunal dhe nivelet tjera nuk janë mbajtur në kohën e paraparë me statut, Kryetari i SBASHK-ut do të caktojë një ushtrues detyre të Kryetarit në kohën prej më së shumti 6 muaj.
2. Gjatë kësaj kohe ushtruesi i detyrës së kryetarit duhet t'i organizojë zgjedhjet.

Neni 80

1. Funksionet në organet e SBASHK-ut janë të papajtueshme me funksionet në politikë dhe autoritetet qeverisëse në nivel qendror e lokal.
2. Kryetarët dhe nënkryetarët e të gjitha nivelet sindikale, të cilët hyjnë në listat zgjedhore për zgjedhjet lokale dhe qendrore në Republikën e Kosovës, duhet të dorëhiqen nga pozitën e tyre, ose në të kundërtën, shkarkohen nga Kryetari i SBASHK-ut.

ZGJEDHJET NË SBASHK

Neni 81

1. Zgjedhjet e rregullta në shoqata sindikale kryhen çdo 5-vite, në bazë të vendimit për shpalljen dhe mbajtjen e zgjedhjeve.
2. Shoqatat Sindikale me rregullat e tyre e rregullojnë mënyrën e përzgjedhjes së anëtarëve të organeve të tyre, në përputhje me Statutin e SBASHK-ut.
3. Kuvendet zgjedhore të Sindikatave Komunale dhe Universiteteve mbahen pas mbajtjeve të zgjedhjeve në shoqata sindikale.
4. Kuvendet zgjedhore të NSAPF, NSAM, NSUSH dhe NSK mbahen pas mbajtjeve të zgjedhjeve në NSK të Arsimit Parauniversitar dhe Sindikatave të Universiteteve.
5. Zgjedhjet në të gjitha nivelet për të gjitha pozitën udhëheqëse dhe anëtarë të forumeve të SBASHK-ut bëhen me votim të fshehtë ndërmjet dy ose më shumë kandidatëve.
6. Është e drejtë e çdo anëtar të iniciojë dorëheqjen ose shkarkimin e udhëheqësve ose anëtarëve të organeve sindikale. Iniciativa duhet të dorëzohet me shkrim me një shpjegim nga organi që ky anëtar i takon, përmes shoqatës sindikale të tij.
7. Zgjedhjet e parakohshme kryhen në bazë të vendimeve të miratuara të Shoqatave Sindikale, Nivelit Komunal dhe SBASHK-ut.

Neni 82

1. Për pozitën udhëheqëse dhe anëtarë të forumeve të SBASHK-ut propozohen kandidatët të cilët zotërojnë aftësi dhe njohuri për përmbushjen e interesave të anëtarësisë dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre, që posedojnë zotësi organizative dhe zotësi tjera për punë sindikale dhe si të tillë gëzojnë reputacion e besim të anëtarësisë.
2. Iniciativa për propozimin e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni mund të iniciojnë edhe organet në nivele më të larta të SBASHK-ut.
3. Anëtarët e SBASHK-ut mund të kryejnë vetëm një funksion në Organet e SBASHK-ut, nëse Statuti i SBASHK-ut nuk e definon ndryshe apo Kryetari i SBASHK-ut nuk ka vendos ndryshe me vendim të posaçëm..

Neni 83



1. Kandidatin për Kryetar të SBASHK-ut e propozon: KD, Kryesia, Kuvendi Komunal apo Shoqata Sindikale.
2. Kandidat për Kryetar dhe Sekretar të Përgjithshëm mund të propozohet një anëtar i cili, në periudhën e kaluar, ka qenë anëtar i kryesisë së nivelit komunal NSKAP, anëtar i kryesisë së niveleve arsimore (NSAPF, NSAM, NSUSH), anëtar i kryesisë së SBASHK-ut, anëtar i komisionit statutor ose komisionit mbikëqyrës të SBASHK-ut, i cili ka së paku 5-vjet anëtarësi në SBASHK-ut dhe përvojë pune në SBASHK ose në institucionet ku SBASHK-u ka anëtarësi.
3. KD i përcakton kriteret për kandidat, hyrjen në procedurën e zgjedhjes për Kryetar si dhe kohën e paraqitjes së kandidaturave, bazuar në Statutin e SBASHK-ut.

Neni 84

1. KD konstituohet pas Kongresit, sipas kriterëve të përcaktuara me këtë Statut.
2. Vendimin për shpalljen dhe mbajtjen e zgjedhjeve e merr KD dhe zbatohet nga organet e SBASHK-ut.
3. KD shpall zgjedhjet për të gjitha organet e SBASHK-ut, në të gjitha nivelet në afat prej së paku 60 ditëve para skadimit të mandatit të organeve Qendrore.

PROCEDURA E ZGJEDHJEVE

Neni 85

1. Zgjedhjet në SBASHK janë me votim të fshehtë nëse ka kunderkandidat, në rast që nuk ka kunderkandidat, votimi bëhet me votim të hapur.
2. Zgjedhjet në të gjitha nivelet i bën Komisionin Zgjedhor. Komisioni Qendror Zgjedhor zgjidhet nga KD së paku 60 ditë para fillimit të zgjedhjeve të rregullta. Komisioni Zgjedhor emëron organet që i menaxhojnë zgjedhjet.
3. Zgjedhjet janë të vlefshme nëse kanë votuar shumica e anëtarëve me të drejtë vote.
4. Kandidati që merr më shumë se gjysmën e votave të anëtarëve prezent, zgjidhet.
5. Për fillimin dhe mbarimin e mandatit të organeve të shoqatave sindikale, me propozim të Kryetarit të SBASHK-ut vendos KD dhe nxjerr vendimin për shpalljen e zgjedhjeve.
6. Mandati i të gjitha organeve tjera, fillon dhe mbaron me ditën e mbajtjes së Kongresit.
7. Në zgjedhje, zgjidhen anëtarët dhe organet e SBASHK-ut me një mandat që e përcakton ky statut.
8. Procedura për zgjedhje të parakohshme është e njëjtë si procesi zgjedhor i rregullt.
9. Organet e SBASHK-ut në përgjithësi ose të anëtarëve të këtyre organeve do të shkarkohen në të njëjtën mënyrë që vlen për zgjedhje përveç nëse është cekur ndryshe në këtë statut.
10. Nëse kandidati në tri raunde nuk merr votat e nevojshme, ndërpritet votimi për të vazhduar në një afat jo me gjatë se 15 ditë dhe ndërrohen kandidatët.

Neni 86

1. Udhëheqësit ose anëtarit të ndonjë organi të SBASHK-ut i ndërpritet mandati:
  - 1.1. Pas skadimit të mandatit;
  - 1.2. Përfundimi i anëtarësimit në SBASHK;
  - 1.3. Me kërkesën e tij;
  - 1.4. Shkeljet e rënda statutore
  - 1.5. Shkarkim nga Kryetari i SBASHK-ut apo organi që e ka zgjedhur;
  - 1.6. Dorëheqja;
  - 1.7. Daljes në pension (mosha 65 vjeç sipas Ligjit të Punës Nr.03/L-212).
2. Në rastet e ndërprerjes së mandatit të udhëheqësit apo anëtarësisë të ndonjë organi sindikal, udhëheqësi apo anëtari i sapozgjedhur ka mandat deri në zgjedhjet e rregullta.

Neni 87

1. Dorëheqja duhet të paraqitet te organi që e ka propozuar ose zgjedhur.
2. Vendimi për shkarkimin, miratohet nga organi kompetent i SBASHK-ut me votim të hapur.
3. Para marrjes së një vendimi për shkarkimin të udhëheqësit apo anëtarit, jepen arsyet për shkarkimin e tij.

FINANCIMI

Neni 88

1. Baza materiale për operimin dhe funksionimin e SBASHK-ut, janë fondet e burimeve nga kuota sindikale, donacione dhe të tjera.
2. Kuota sindikale paguhet drejtpërdrejt nga anëtarësia, ndërsa SBASHK-u krijon kushte për ndalimin e kuotës sindikale përmes listës së pagave.

## STATUTI I SBASHK-ut

2025

3. Shoqatat sindikale mund të përcaktojnë një sasi më të lartë të kuotës sindikale me kusht që pjesa mbi % e përcaktuar me këtë statut të mbetet për nevoja të shoqatës.
4. Përdorimi i të hyrave nga kuota sindikale, përdoret në mënyrë rigoroze sipas Rregullores së miratuar nga Kryesia e SBASHK-ut dhe secili nivel i organizimit jep përgjegjësi për menaxhimin e pjesës që i takon për menaxhim.
5. Anëtarë nuk mund të kërkon rimbursim të kuotës sindikale në asnjë rrethanë.

### Neni 89

SBASHK-u ndjek procedurat për çështjet financiare në përputhje me ligjet dhe standardet e përcaktuara në Republikën e Kosovës.

## INFORMACION

### Neni 90

1. SBASHK-u informacionin dhe edukimin mund ta bëjë përmes hapjes së një Qendre për Arsim e informim.
2. Organizimi i punës dhe juridiksioni i Qendrës duhet të themelohet nga KD me akt të veçantë.
3. Të gjitha organet e SBASHK-ut dhe organizatave tjera që verpojnë në kuadër të SBASHK-ut orgainzojnë seminare, punëtori, kurse etj. Janë të obliguara të raportojnë që punën e tyre, të sigurojnë informacione të sakta dhe të plota në kohë reale
4. KD dhe Kryesia e SBASHK-ut për punën e vet dhe aktivitetet i informon shoqatat sindikale, anëtarësinë dhe opinionin e gjerë në media, web site, revista, broshura dhe forma të tjera.

## SHËRBIMI PROFESIONAL

### Neni 91

1. Detyrat profesionale, administrative dhe teknike kryhen nga shërbimi profesional i SBASHK-ut.
2. Kryesia me akte normative të veçanta përcakton organizimin e punës, detyrat, përgjegjësitë dhe mbikëqyrësin e punës, të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni.

## SHPËRBLIME

### Neni 92

1. KD, Kryetari, Sekretari i Pergjithshëm dhe Kryesia, mund të jap shpërblime/mirënjohje anëtarëve të SBASHK-ut për kontribut të veçantë në arsim dhe veprimtari sindikale.
2. Propozimin dhe kriteret për dhënien e shpërblimeve e përgatit Kryetari ose Kryesia.

## DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

### Neni 93

1. Ky Statut hyn në fuqi në momentin e miratimit nga Kongresi jashtëzakonshëm i SBASHK-ut.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij Statuti, përfundon vlefshmëria e Statutit të datës, 02 prill 2022.
3. Ndryshimet në këtë Statut do të bëhen sipas procedurës me të cilin është miratuar.
4. Ndryshime në Statut midis dy Kongreseve me propozimin e Kryetarit apo Komisionit Statutor mund të bëjë KD në qoftë se për këto ndryshime votojnë së paku dy të tretat e anëtarëve të KD prezent.

### Neni 94

Shoqatat sindikale dhe organet tjera në të gjitha nivelet obligohen që brenda dy muajve të harmonizojë politikën, vendimet dhe dokumentet tjera në përputhshmëri me këtë Statut.

Prishtinë, 18 korrik 2025



Kryetari i SBASHK-ut

*R. Jasharaj*  
Rrahman Jasharaj